



Kosovar Center for Security Studies

A stylized map of the Balkans region, including Kosovo, Serbia, Albania, and parts of Greece and Bulgaria. The map is rendered in various shades of blue, with Kosovo highlighted in a lighter blue. The map is overlaid with a dark blue horizontal band containing the title text.

Anëtarësimi dhe përfaqësimi i Kosovës

në nismat rajonale të sigurisë

Shtator 2014



Anëtarësimi dhe përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale të sigurisë

Shtator 2014

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Donika Emini

Recensioni i brendshëm nga: Florian Qehaja dhe Mentor Vrajolli

Recensioni i jashtëm nga: Shpend Kursani

Projekti u mbështet nga: Tringa Naka

Redaktuar nga: Alastair Cassell

© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me *ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta* 2011/04-L-065

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem informativ, ose të transmetohet në ndonjë formë apo përmes ndonjë mjeti elektronik, mekanik apo formë tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim nga botuesi.

Pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk i shprehin medoemos pikëpamjet e donatorëve apo të partnerëve të saj.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
HYRJE.....	8
METODOLOGJIA	9
SEKSIONI 1.....	10
Kosova pas Pavarësisë: Sfidat në Përfaqësimin Rajonal	10
Aspekte të përgjithshme – Kosova përballë nismave rajonale të sigurisë	11
Dialogu Kosovë-Serbi: cilat janë implikimet për bashkëpunimin rajonal në fushën e sigurisë?	12
SEKSIONI 2.....	14
Nismat rajonale dhe bashkëpunimi në fushën e sigurisë në Evropën Juglindore	14
SEKTORI I MBROJTJES.....	15
Karta e Adriatikut - A5	15
PSOTC – Qendra Trajnuese për Përkrahjen e Operacioneve Paqësore	16
RACVIAC – Qendra për Asistim në Implementim dhe Verifikim të Kontrollit Rajonal të Armëve	16
SEDM – Ministrat e Mbrojtjes së Evropës Juglindore	17
BASHKËPUNIMI RAJONAL SA I PËRKET POLICISË DHE SUNDIMIT TË LIGJIT	18
SECI – Iniciativa e Evropës Juglindore për Bashkëpunim	18
SEECF – Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore	19
ILECU – Njësia Koordinuese për Zbatimin e Ligjit Ndërkombëtar.....	20
PCC SEE – Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore	21
Rrjeti i prokurorëve të Ballkanit Perëndimor	21
PËRFUNDIM	23
REKOMANDIME.....	24
LISTA E ANEKSEVE	25
Përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale të sigurisë	25
BIBLIOGRAFI.....	26
INTERVISTAT	29

LISTA E SHKURTESAVE

FABH	Forcat e Armatosura të Bosnje dhe Hercegovinës
KK	Kuvendi i Kosovës
RSSS	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
BH	Bosnja dhe Hercegovina
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
EUROPOL	Agjencia Evropiane për Zbatim e Ligjit
KPO	Kapacitetet e Plota Operacionale
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Mbrojtjen e Kufijtë të Jashtëm
ILECUs	Njësia Koordinuese për Zbatimin për Zbatimin Ndërkombëtar të Ligjit
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
KSK	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë e Kosovës
GKSH	Grupi Këshillues Shumëkombësh
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MF	Ministria e Financave
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OLAF	Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit – Komisioni Evropian
PCCSEE	Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore
PP	Partneriteti për Paqe
PSOTC	Qendra Trajnuese për Përkrahjen e Operacioneve Paqësore
RACVIAC	Qendra për Asistim në Implementim dhe Verifikim të Kontrollit Rajonal të Armëve
KBR	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
SECI	Iniciativa e Evropës Juglindore për Bashkëpunim
SEDMD	Ministrat e Mbrojtjes së Evropës Juglindore
EJL	Evropa Juglindore
SECH	Qendra e Evropës Juglindore për Kontroll të Armëve të Vogla dhe të Lehta
SEECIP	Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore
SELEC	Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore
SIS	Sistemi Informativ Shengen
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSC	Këshilli i Sigurimi i Kombeve të Bashkuara
ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
KB	Kombet e Bashkuara

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë viteve të fundit kanë filluar të inicohen një varg nismash rajonale në Evropën Juglindore, të cilat janë mbështetur kryesisht prej institucioneve të Bashkimit Evropian (BE), shteteve anëtare të BE-s, si dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ka treguar gatishmëri të vazhdueshme, si dhe ka ndërmarrë veprime, që t'i bashkohet nismave rajonale të sigurisë. Aktualisht ekzistojnë rreth dyzet nisma rajonale që merren me një varg sektorësh/çështjesh që kanë të bëjnë me bashkëpunimin policor, me sektorin e gjyqësisë, të ushtrisë, si dhe me emergjencat. Disa prej tyre veçse janë pjesë e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR), mirëpo Kosova është pjesë e vetëm disa prej tyre, drejtpërdrejtë - përmes përfaqësimit të institucioneve shtetërore, ose përmes pranisë ndërkombëtare.

Kosova, në veçanti, ka vështirësi sa i përket qasjes së saj në nismat rajonale në sektorin e sigurisë. Përderisa anëtarësimi i Kosovës, tash së voni, në KBR është pritur t'ia hapë dyert e përfaqësimit dhe të qasjes në nismat e tjera rajonale të sigurisë, të gjeturat e këtij studimi, megjithatë, tregojnë se progresi në këtë drejtim është mjaft i kufizuar dhe shoqërohet me sfida nga më të ndryshme. Duke qenë anëtare e re, Kosova ka kufizime në përfitimet që mund të vijnë prej veprimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit, të drejtësisë dhe të sigurisë. Si pasojë e kësaj, sfidohen seriozisht edhe marrëveshjet politike të arritura në dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, si dhe vet koncepti i bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor.

HYRJE

Integrimi i Kosovës në nismat rajonale mbetet një ndër prioritetet kryesore afatgjate të qeverisë së Kosovës. Ambicia e përfaqësimit në nismat rajonale e manifeston vizionin e vendit dhe të qytetarëve të Kosovës për integrim në strukturat Euro-Atlantike. Megjithatë, siç do ta argumentojmë në këtë dokument, qasja e Kosovës në nismat rajonale të sigurisë është tejet e kufizuar për shkak të sfidave që ka Kosova në konsolidimin e institucioneve shtetërore dhe të përpjekjeve politike në forcimin e shtetit. Sidoqoftë, kur e shohim brenda kontekstit, argumentet për një “politikë me dyer të mbyllura” karshi Kosovës nuk janë të qëndrueshme për shkak të përmirësimit gradual, megjithëse të ngadalshëm, shoqëror, politik dhe institucional. Në veçanti, procesi i kalimit të institucioneve të Kosovës nga përgjegjësia e bashkësisë ndërkombëtare tek institucionet shtetërore të Kosovës shënon një sukses të rëndësishëm në rritjen e pjekurisë politike dhe institucionale të vendit. Një kthesë e madhe në trajektoren e kalimit të përgjegjësive u shënuar në shtator të vitit 2012 kur Kuvendi i Kosovës, në bashkërendim me partnerët ndërkombëtarë, i dha fund zyrtarisht mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Në anën tjetër, progresi vërehet edhe në kontekstin e reformave institucionale, veçanërisht në sektorin e sigurisë. Pika më kulmore në këtë drejtim ishte procesi i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), të cilin qeveria e Kosovës e nisi në mars të vitit 2012. RSSS-ja pasqyron një qasje holistike institucionale, duke i përfshirë një varg institucionesh të sigurisë, siç janë: Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK), Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), Ministria e Drejtësisë (MD), Ministria e Financave (MF), si dhe institucionet e tjera përkatëse. RSSS-ja, që zgjati dy vjet, përfundoi zyrtarisht në mars të vitit 2014 me fillimin e realizimit të **‘Analizës së Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS)’**. Përveç propozimit të reformave institucionale, në përgjithësi, dhe të zhvillimit të sektorit të mbrojtjes, në veçanti, RSSS-ja ofroi propozime sa i përket objektivave të institucioneve të sigurisë së Kosovës për themelimin e bashkëpunimit dypalësh në siguri, si dhe të hyrjes në marrëdhënie shumëpalëshe me organizata të ndryshme, përfshirë edhe nismat rajonale të sigurisë.

Konsolidimi i institucioneve është po aq i rëndësishëm sa pozicionimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në këtë drejtim, marrëdhëniet me Serbinë dhe BE-në janë me rëndësi të veçantë. Siç do të argumentojmë në pjesën tjetër të këtij punimi, BE-ja ndihmoi në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, e cila edhe pse pritej se do t’i hiqte pengesat e përfshirjes së Kosovës në nismat rajonale, megjithatë, nuk e ndryshoi gjendjen aktuale. Gjatë dialogut, të dy palët e përfshira në negociatën e arritën një marrëveshje, e cila i përkufizonte specifikat dhe modalitetet se si do të përfaqësohej Kosova në nismat dhe mekanizmat rajonale. Njëra prej marrëveshjeve kryesore mes Kosovës dhe Serbisë, e cila supozohej se do t’ia mundësonte Kosovës pjesëmarrjen

dhe anëtarësimin në organizatat rajonale, është e ashtuquajtura ‘marrëveshja e fusnotës’. Megjithatë, periudha pas marrëveshjes na jep një pamje të atillë që tregon se qasja e Kosovës në mekanizmat e bashkëpunimit rajonal të sigurisë është e kufizuar deri në atë masë sa mund të thuhet se është inekzistent.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të vihet në pah progresi i bërë në këtë drejtim, si dhe të identifkohet sfidat që i kanë institucionet e Kosovës për t’u bërë anëtare e plotë e nismave rajonale të sigurisë. Po ashtu, QKSS ka për synim që ta përdor këtë punim si një platformë avokimi për t’i plotësuar përpjekjet e institucioneve në pjesëmarrjen e tyre në të gjitha nismat rajonale, dhe kështu të rritjes së partneritetit të tyre në fushën e mbrojtjes, sigurisë dhe të sundimit të ligjit. Ekipi i QKSS beson se kjo çështje duhet të shihet edhe nga perspektiva e qytetarëve, krahas këndvështrimit institucional, për shkak se bashkëpunimi, apo mosbashkëpunimi, rajonal ndikon drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

METODOLOGJIA

Ky punim ka për qëllim të analizojë kontekstin politik të nismave rajonale të sigurisë. Ofron një vështrim të 9 nismave të caktuara: 1) **Spektori i mbrojtjes**: Karta e Adriatikut A5; Qendra Trajnuese për Përkrahjen e Operacioneve Paqësore (PSOTC); Qendra për Siguri dhe Bashkëpunim (RACVIAC); Ministrat e Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM); dhe 2) **Spektorin e policisë**: Iniciativa e Evropës Juglindore për Bashkëpunim (SECI), Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (SEECF); Njësitë koordinuese të zbatimit të ligjit ndërkombëtar (ILECU); Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (PCCSEE), dhe Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor. QKSS-ja e ka bërë përzgjedhjen e nismave në bazë të disa indikatorëve, siç janë: a) rëndësia e nismave; b) fushëveprimi i nismave, dhe; c) nismat proaktive që kanë së paku sekretariat dhe/ose program. QKSS-ja ka për synim ta vlerësojë progresin e bërë deri më tani duke e krahasuar atë me gjendjen ekzistuese dhe me sfidat që i ka përpara Kosova në këtë drejtim.

Ky hulumtim është realizuar duke i pasur parasysh metodat kualitative të hulumtimit, dhe se bazohet kryesisht në analiza të thella të dokumenteve juridike dhe politike, të konventave, të marrëveshjeve, dhe të raporteve zyrtare, të cilat janë përpiluar si nga organizatat vendore ashtu edhe nga ato ndërkombëtare. Të dhënat e mbledhura janë mbështetur edhe prej intervistave kokë më kokë me palët kryesore të interesit, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Ekipi ka realizuar intervista me: Policinë e Kosovës (PK), Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Ministrinë e Drejtësisë (MD), Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), dhe me Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK).

SEKSIONI 1

Kosova pas Pavarësisë: Sfidat në Përfaqësimin Rajonal

Që prej vitit 1999 bashkësia ndërkombëtare është përpjekur pandërprerë ta gjejë një zgjidhje për statusin përfundimtarë të Kosovës. Para shpalljes së pavarësisë, UNMIK-u ishte autoriteti i vetëm zyrtar për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të Kosovës, si dhe ta përfaqësonte atë në nismat dhe organizatat rajonale e ndërkombëtare.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008 shënoi një kthesë të rëndësishme në marrëdhëniet e Kosovës për shkak se që prej atëherë Kosova është angazhuar si shtet i pavarur dhe sovran në krijimin e marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale me shtetet dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Në këtë drejtim, përpjekjet e Kosovës pas pavarësisë janë sfiduar në mënyra dhe për arsye të ndryshme. Duke e pasur parasysh faktin që pavarësia e Kosovës nuk u pranua prej të gjithë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSC), institucionet e sapo themeluara të saj, pas shpalljes së pavarësisë, nuk mund të ishin trashëgimtare të drejtpërdrejta të institucioneve të UNMIK-ut. Si rezultat, Kosova nuk posedon një mënyrë të unifikuar të përfaqësimit në organet rajonale dhe ndërkombëtare – në disa prej organeve rajonale, Kosova përfaqësohet si shtet i pavarur, e në disa të tjera përfaqësohet prej UNMIK-ut ose EULEX-it. Ka raste kur kemi një përzjerje të këtyre tri organeve përfaqësuese. Për shembull, sipas z. Rrecaj, drejtor në Drejtorinë e Trajnimeve të Specializuar në PK, ka pasur raste kur ftesa për të marrë pjesë në disa prej nismave rajonale është dërguar në adresë të gabuar, ose duhej të ndahej mes EULEX-it, UNMIK-ut dhe institucioneve kosovare.

Trajektorja e varësisë institucionale ndaj misioneve ndërkombëtare ndryshoi rrënjësisht me vendimin që të përfundohej pavarësia e mbikëqyruar në shtator të vitit 2012. Ky vendim i hapi perspektivë të re Kosovës në angazhimin e saj në nisma dhe organe të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. Për sektorin e sigurisë, përfundimi i pavarësisë së mbikëqyruar nënkuptonte dorëzimin përfundimtar të përgjegjësisë nga mbikëqyrësit ndërkombëtarë tek institucionet kosovare të sigurisë. Edhe pse prania dhe ndikimi i aktorëve ndërkombëtarë në sektorin e sigurisë në Kosovë nuk është zvogëluar tërësisht, megjithatë kemi një progres të dukshëm në këtë drejtim. Për shembull, pjekuria institucionale e Kosovës është demonstruar me vet faktin që NATO-ja i ka deklaruar Kapacitetet e plota operacionale (KPO) për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). Kjo nënkuptonte se FSK-ja është e aftë që t'i kryer detyrat dhe ta përmbush misionin e saj sipas standardeve të NATO-s. Këto procese dhanë një grimcë shprese për një përfshirje më të mirë rajonale në fushën e sigurisë.

Si pjesë e hapave për konsolidimin e institucioneve të saja pas shpalljes së pavarësisë, qeveria e Kosovës mori vendim që të fillonte procesin e RSSS (Mars 2012 – mars 2014).

Kjo do të thoshte se qeveria e Kosovës ka vullnet të ndërmerr reforma të rëndësishme që kanë të bëjnë me sigurinë, dhe se Kosova, si shtet, synon të përfaqësohet në nivel rajonal. Natyrisht se RSSS-ja nuk e anashkalon kontributin e palës ndërkombëtare në procesin e zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë; porse, sipas këtij dokumenti, përgjegjësia kryesore është në duart e institucioneve vendore.

Aspekte të përgjithshme – Kosova përballë nismave rajonale të sigurisë

Sfidat e qasjes së Kosovës në nismat rajonale të sigurisë janë kryesisht politike. Në realitet, bllokadat dhe dilemat që vijnë prej shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, dhe të cilat drejtohen nga Serbia në të shumtën e rasteve (Lehne, 2012:5), paraqesin shqetësim të veçantë për vendin. Për ta siguruar mbështetjen e plotë të shteteve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, MPJ e Kosovës ka nisur së zbatuari një strategji të veçantë, e cila ka për synim rritjen e numrit të njohjeve dhe të përmirësimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar (MPJ, 2011: 6-7). Kjo strategji është e ndarë në tri pjesë kryesore, të cilat merren me aspekte të përgjithshme dhe me qëllimin e strategjisë, si dhe në pjesën e dytë bëhet fjalë për aspektet operative dhe marrëdhëniet e Kosovës me shtetet që nuk e kanë njohur atë. Kjo strategji përfundon me një plan konkret të veprimit. Megjithatë, strategjia e MPJ-së nuk ariti që t'i përmbush rezultatet e pritshme, që rezultoi në një politikë mjaft të pasuksesshme të jashtme sa i përket nismave rajonale të sigurisë. Si pasojë, mundësia për të themeluar marrëdhënie multilaterale është e kufizuar dhe varet kryesisht prej shteteve anëtare të secilit mekanizëm, nisme apo organizate (Zela, 2013: 637-638). Së këndejmi, bashkëpunimi ndryshon prej një nisme në tjetrën, varësisht prej fuqisë së secilit shtet anëtar, i cili nuk e ka njohur shtetësinë e Kosovës. Qasja e mirëfilltë në nismat rajonale lidhet edhe me përpjekjet e Kosovës për njohje ndërkombëtare të cilat, përkundër 108 njohjeve nga shtetet anëtare të OKB-së, kanë ngecur për shkak të mosnjohjes së 5 shteteve anëtare të BE-s. Fakti që Serbia, Bosnja dhe Hercegovina (BH) dhe Moldavia janë pjesë e këtyre nismave krijon edhe më shumë pengesa.

Gjersa ka pasur suksese në integrimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare dhe nismat rajonale që nuk kanë të bëjnë me sigurinë, prapë se prapë procesi i integrimit në nismat e sigurisë mbetet ende një prej sfidave më të mëdha për Kosovën. Logjika e ndërlihdjes së institucioneve të sigurisë me shtetësinë e Kosovës, dhe me vetë faktin se shumica e institucioneve të tilla ushtrojnë masa shtrënguese, paraqet një prej sfidave më të mëdha në qasjen e suksesshme të Kosovë në nismat rajonale. Sido që të jetë, rajoni i Ballkanit Perëndimor përballlet me kërcënime të ndryshme nga krimi i organizuar, veprimtaritë kriminale që i tejkalojnë kufijtë e vetëm një shteti, terrorizmi, korrupsioni, etj., me të cilat duhet të merremi në nivel rajonal. Si rrjedhojë, është me shumë rëndësi për Kosovën që të përfshihet në nismat dhe angazhimet rajonale, si dhe të zhvillojë bashkëpunime të këtij niveli. Luftimi i krimit dhe i kërcënimeve të tjera ndaj Kosovës dhe rajonit kërkon bashkërendim të hapur ndërmjet shteteve të rajonit, i cili deri më tani nuk ka qenë i suksesshëm.

Pikërisht për gatishmërinë e treguar për të marrë pjesë në luftën për parandalimin e kërcënimeve të cilat u cekën më lartë, Kosova ka shfaqur vullnet të vazhdueshëm që të bëhet anëtare e nismave kryesore rajonale, si dhe ta hap rrugën e vet drejt integritimeve transatlantike (Strategjia Kombëtare për Integrim Evropian “Kosova 2020”, 2014: 61-62).

Dialogu Kosovë-Serbi: cilat janë implikimet për bashkëpunimin rajonal në fushën e sigurisë?

Bashkëpunimi rajonal, në përgjithësi, dhe mundësitë e Kosovës për të marrë pjesë në nismat rajonale, në veçanti, kanë qenë një prej kriterëve apo elementeve kryesore në forcimin e pozitës së Kosovës në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian (BE), në procesin e anëtarësimit në NATO dhe më tej. Së këndejmi, bisedimet politike midis Prishtinës dhe Beogradit, të ndërmjetësuara nga BE-ja, nisën në tetor të vitit 2012¹ me qëllim që të normalizohen marrëdhëniet mes këtyre dy shteteve. Kjo periudhë, e cila karakterizohet me një dialog të intensifikuar mes Kosovës dhe Serbisë, e cila rezultoi në arritjen e disa marrëveshjeve. Shumica e këtyre marrëveshjeve nuk janë zbatuar ende, posaçërisht ‘marrëveshja për fusnotën’ e cila kishte për qëllim që t’i hiqte pengesat me të cilat përballëj Kosova në anëtarësimin dhe përfaqësimin e saj në nismat rajonale (Deda dhe Qosaj-Mustafa, 2013: 21.22).

‘Marrëveshja për fusnotën’ paraqet një konsensus, si i Kosovës ashtu edhe i Serbisë, me synim që t’ia hap dyert Kosovës. Serbia pranoi që Kosova të mund të përfaqësohej dhe të anëtarësohej në organizatat rajonale si palë më vete, pa UNMIK-un apo palët e tjera ndërkombëtare që të jenë të pranishme në nisma të tilla në emër të Kosovës. Kosova, në anën tjetër, e pranoi që emri i saj zyrtar të ndryshohej prej ‘Republika e Kosovës’ në ‘Kosova*’ me një yllth që e nënkupton fusnotën e cila thotë se *“Ky emërtim nuk ndikon në qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të KB – së dhe me mendimin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”*. Më tej, aty ceket qartë se duhet të shmangët përdorimi i simboleve kombëtare: *“Nikoqirët e takimeve do të inkurajohen që të shmangin shfaqjen e simboleve nacionale përveç të tyre dhe të BE-së, duke marrë parasysh statutet e organizatave përkatëse”* (Dialogu i ndërmjetësuara nga BE: *Marrëveshja në bashkëpunimin rajonal*, 212: neni: 3 dhe 7).

Këto kompromise ishin pjesë e përpjekjeve të të dyja palëve për ta përshpejtuar perspektiven e tyre në proceset integruese të BE-së. Kosova, po ashtu, shpresonte se duke e pranuar ‘marrëveshjen e fusnotës’, pozita e pesë anëtarëve të BE-së, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, do të ndryshonte dalë nga dalë (Foreign Policy Initiative, 2013: 10). ‘Marrëveshja për fusnotën’ pritej të sillte një dinamikë të re të bashkëpunimit rajonal dhe t’ia hapte dyert Kosovës që të bëhej pjesë e nismave rajonale të sigurisë, të grupeve punuese

¹ Dialogu teknik mes Kosovës dhe Serbisë ka filluar në mars të vitit 2011, ndërsa dialogu politik mes kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë ka filluar në tetor të vitit 2012.

dhe të strukturave të tjera që janë ndërtuar gjatë dekadave të fundit me qëllim që të rritet bashkëpunimi ndërmjet shteteve të Ballkanit. Por, përkundër kompromiseve që i ka bërë Kosova sa i përket marrëveshjes, periudha pas marrëveshjes e paraqet një realitet në të cilën Kosova pak e ka përmirësuar përfaqësimin e saj, sidomos në nivel rajonal. Marrëveshja nuk arriti t'i përmbushte pritjet fillestare; andaj, rezultoi në qasje të kufizuara, e madje edhe mosekzistim të mundësive të tilla, në nismat e ndryshme.

Në anën tjetër, marrëveshja ia solli Kosovës disa përfitime, siç është anëtarësimi i saj në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (KBR). Në tetor të vitit 2013, Kosova iu bashkua strukturës së KBR-së, një organizatë rajonale që përbëhet prej 46 shteteve, prej organizatave të ndryshme, dhe prej institucioneve financiare ndërkombëtare. Pjesëmarrja e Kosovës në KBR është konsideruar një arritje shumë e rëndësishme në kuadër të përfshirjes rajonale (Komisioni, 2013: 20). Duke e pasur parasysh faktin që KBR-ja e përfaqëson një prej organizatave kryesore ombrellë të bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore (RCC, 2010: 12-15), atëherë institucionet e Kosovës e panë këtë anëtarësim si rrugë drejt procesit të para-anëtarësimin në BE dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë (Remikovic & Karadaku, 2013). Megjithatë, përkundër pritjeve të arsyeshme, anëtarësimi nuk rezultoi në përfshirjen aktive të Kosovës në rrjetin dhe projektet e KBR-së. Së këndejmi, edhe pas një viti të anëtarësimin, përfitimet e Kosovës nga ky anëtarësim në KBR nuk arrijnë të shkojnë përtej njohjes zyrtare si anëtare. Pas një viti të anëtarësimin, Kosova nuk është ende pjesë e 14 nismave që janë pjesë e KBR-së. Kjo tregon se vendi nuk arriti të përfitonte prej një varg projektesh dhe aktiviteteve në fushën e sigurisë (Intervistë me zyrtarë të MPJ-së).

SEKSIONI 2

Nismat rajonale dhe bashkëpunimi në fushën e sigurisë në Evropën Juglindore

Siç është cekur më parë, bashkëpunimi dhe anëtarësimi në fushën e sigurisë është një prej proceseve më delikate dhe më sfiduese. Aktualisht ekzistojnë rreth 40 nisma rajonale të cilat përfshijnë një varg të çështjeve të sigurisë, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me bashkëpunimin e policisë, gjyqësorin, ushtrinë, dhe emergjencat – disa prej të cilave janë pjesë e KBR-së (Kušljugić, 2009: 47-49). Deri në shtator të vitit 2014 Kosova ka arritur të bëhet anëtare vetëm e dy prej këtyre nismave (SEECIP dhe ILECU), ndërsa vazhdon të ngec në anëtarësimin e saj në nismat e tjera, ku Kosova kryesisht ose vazhdon të pres përgjigje ose i kthehen refuzime të qarta.

Procesi i anëtarësimit të Kosovës në nismat dhe organizatat rajonale po sfidohet prej dy elementeve të fuqishme: e para ka të bëjë me mungesën e njohjeve dhe pozitën e dobët diplomatike të Kosovës; e dyta ka të bëjë me rezistencën e fortë të Serbisë dhe vendeve të tjera, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, për ta shmangur zbatimin e marrëveshjes, dhe duke e lënë kështu Kosovën jashtë shumë proceseve të rëndësishme të nivelit rajonal.

Ngecjet në procesin e anëtarësimit dhe të mos-përfshirjes në nisma të tilla po e dëmton Kosovën si në dimensionin politik ashtu edhe në atë diplomatik e teknik. Duke qenë jashtë mekanizmave rajonalë të sigurisë, Kosova nuk mund të kontribuojë në luftën kundër kërcënimeve të përbashkëta në fushën e sigurisë. Përveç kësaj, argumenti dhe ideja e përgjithshme apo perceptimi që Kosova përfaqëson 'një vend transit për krimin e organizuar' është e paqëndrueshme si opinion i tillë i shteteve skeptike, të cilat e bllokojnë kërkesën e Kosovës që të bëhet anëtare e nismave që merren me luftimin e krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Pamundësia që të bëhet anëtare me të drejta të plota në nismat rajonale i paraqesin Kosovës edhe sfida të tjera. Së pari, vendit po i mohohet mundësia që ta pozicionojë veten si palë e barabartë aktive në rajon, posaçërisht në mesin e fqinjëve të vet. Së dyti, nënkupton se Kosova nuk mund t'i përmbush kriteret e bashkëpunimit rajonal në kontekstin e integriteteve euroatlantike. Së treti, megjithëse një çështje më shumë teknike, Kosova po parandalohet që të përfitojë prej veprimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta në fushën e sundimit të ligjit, drejtësisë dhe të sigurisë. Së fundmi, institucionet e Kosovës pengohen që të përfitojnë prej një programi të përbashkët të trajnimeve, të praktikave që mësohen përmes aktiviteteve të përbashkëta mes vendeve të rajonit.

Seksionet në vijim fokusohen vetëm në nismat kryesore rajonale në të cilat Kosova synon të bëhet anëtare. Ato ndahen në dy pjesë kryesore, në të cilat analizohet sektori i mbrojtjes dhe i bashkëpunimit policor/sundimit të ligjit.

SEKTORI I MBROJTJES

Karta e Adriatikut - A5

Karta e Adriatikut është rezultat i samitit të NATO-s në Pragë, i mbajtur në nëntor të vitit 2002, i cili e përforcoi mbështetjen amerikane që e mbante 'derën e hapur' të aleancës për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë, Kroacisë, dhe Maqedonisë (anëtarët fillestare të kartës) në NATO dhe në institucionet e tjera euroatlantike. Dy të parat u bënë anëtare të NATO-s në vitin 2009. Karta e konfirmon përkushtimin e përbashkët politik të palëve për t'i forcuar institucionet demokratike, shoqërinë civile, sundimin e ligjit, tregun ekonomik, dhe që ushtritë e tyre të jenë në përputhje me standardet e NATO-s. Më tej, karta u bën thirrje të gjitha palëve të angazhohen në luftën kundër korrupsionit dhe krimit, si dhe t'i mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të të gjithë individëve në Shqipëri, Kroaci, Maqedoni, dhe në vendet e tjera të Evropës Juglindore (RCC, RCC and Regional Initiatives and Task Forces in South East Europe, 2014).

Karta u nënshkrua në maj të vitit 2003 në Tiranë nën udhëheqjen e SHBA-ve. (Marrëveshja e Kartës së Adriatikut, 2003). Roli i Shteteve të Bashkuara ka shkaktuar pak pështjellim, si dhe ka ngjallë debate, duke bërë që karta shpesh të quhej Karta e Adriatikut-SHBA. Kjo nismë u zgjerua më tej kur Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina u anëtarësuan në dhjetor 2008. Në të njëjtën kohë, edhe Serbia e mori statusin e vëzhguesit. Kështu në vitin 2009 nisma, e cila njihet fillimisht si A-3 (për shkak të anëtarëve fillestar: Shqipërisë, Kroacisë, dhe Maqedonisë), u bë A-5 për shkak të anëtarëve shtesë, përkatësisht Malit të Zi dhe BH-së (Departamenti i Shtetit, 2011).

Kosova po ashtu synon të bëhet anëtare e A-5 (pra që karta mundësisht të bëhet në A-6); megjithëkëtë, për shkak të statusit të saj të kontestuar nga Bosnja dhe Hercegovina, një anëtare e plotë e A-5, tani për tani mundësitë e anëtarësimit të Kosovës në këtë nismë nuk duken shumë optimiste. Përkundër këtyre sfidave, Kosova ka aplikuar për anëtarësim në A-5 në vitin 2012, por për shkak të rrethanave të përmendura më lartë, anëtarësimi i saj është shtyrë (Syla, 2014). Megjithatë, është me rëndësi ta përmendim se Kosova veç se ka marrë pjesë në disa prej aktiviteteve dhe ngjarjeve të kartës në kapacitetin e vëzhguesit. Qëllimi përfundimtar mbetet anëtarësimi i saj i plotë në këtë kartë – një proces që varet kryesisht në faktorë të caktuar të brendshëm e të jashtëm, por kryesisht në vullnetin e disa shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, në të cilat do të duhet të përfshihej Serbia dhe shtetet e tjera anëtare (Këshilli i Atlantikut, 2014).

PSOTC – Qendra Trajnuese për Përkrahjen e Operacioneve Paqësore

Qendra Trajnuese për Përkrahjen e Operacioneve Paqësore (PSOTC) është një organizatë e cila synon ta zhvillojë shkollimin dhe trajnimin në fushën e operacioneve paqësore për Forcat e Armatosura të Bosnje dhe Hercegovinës (FABH) (PSOTC, 2014:4-5). PSOTC është një qendër e akredituar e Partneritetit për Paqe për trajnim dhe shkollim, e cila organizohet prej Qendrës së Evropës Juglindore për Kontroll të Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEEC), dhe Karta e Adriatikut (A5) (PSOTC, 2014). Kjo nismë vepron edhe si partnere e NATO-s, duke shërbyer kryesisht si qendër kryesore rajonale e trajnimit në përputhje me standardet e NATO-s dhe të OKB-së.

Megjithatë, Kosova nuk ka mundur të marr pjesë as në ngjarjet e PSOTC e as të përfitoj prej programeve të saj të trajnimit. Kosova ka shfaqur gatishmëri t'i bashkohet PSOTC, por, për shkak të çështjes së statusit, nuk është ftuar t'i bashkohet apo të përfitojë prej ndonjërit prej programeve të saj. Përfaqësuesit nga MFSK-ja kanë bërë përpjekje që ta nisin bashkëpunimin me PSOTC në nivel joformal si dhe të avokojnë për themelimin e marrëdhënieve formale, porse kërkesat e tyre janë kthyer prapa pa sukses (Geci, 2014).

RACVIAC – Qendra për Asistim në Implementim dhe Verifikim të Kontrollit Rajonal të Armëve

Qendra për Siguri dhe Bashkëpunim (RACVIAC) është pasuesi i ligjshëm i Qendrës për Asistim dhe Verifikim të Kontrollit Rajonal të Armëve. RACVIAC është një organizatë ndërkombëtare, e pavarur dhe jo fitimprurëse, me synimin kryesor nxitjen e bashkëpunimit dhe të dialogut në fushën e sektorit të sigurisë në Evropën Juglindore. RACVIAC synon ta përmbush qëllimin e vet përmes partneritetit ndërmjet shteteve rajonale dhe partnerëve ndërkombëtarë (Misioni i RACVIAC). RACVIAC është inicuar në bazë të marrëveshjeve të caktuara, duke filluar nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore i nënshkruar në Koln në vitin 1999, dhe ka për synim arritjen e qëndrueshmërisë, paqes, dhe stabilitetit në Evropën Juglindore. Vetëm në vitin 2000 RACVIAC u themelua në Qendër për Asistim në Implementim dhe Verifikim të Kontrollit të Armëve, si pjesë e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, me synim të ofrimit të trajnimeve lidhur me kontrollin e armëve, promovimit të mirëbesimit, të zhvillimit të masave të sigurisë dhe zgjerimit të bashkëpunimit në Evropën Juglindore (EJL). Në vitin 2001, Qendra e mori statusin e organizatës ndërkombëtare me pronësi rajonale, dhe e mori emrin që e ka sot RACVIAC – Qendra për Siguri dhe Bashkëpunim (Marrëveshja për RACVIAC, 2001: neni 1).

Aktualisht, RACVIAC i ka 29 shtete anëtare të ndara në tri grupe: (1) shtetet anëtare në përbërje prej tetë vendeve të SEECP: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Turqia; (2) shtetet e asocuara – të gjitha shtetet e tjera që dëshirojnë të kontribuojnë dhe ta mbështesin dialogun dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë në

Evropën Juglindore, si: Austria, Republika Çeke, Danimarka, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Holanda, Norvegjia, Rusia, Sllovenia, Spanja, Suedia, dhe Mbretëria e Bashkuar; dhe (3) shtetet e tjera, institucionet ose organizatat, të cilat marrin pjesë në aktivitetet e RACVIAC si vëzhguese, ku në këtë grup aktualisht janë Kanadaja, Polonia, Sllovakia, Ukraina dhe SHBA-të (Busek & Kühne, 2010: 108-109).

Kosova ka treguar gatishmëri të vazhdueshme që të bëhet anëtare e RACVIAC; megjithatë, vendimi për anëtarësimin e Kosovës pritet të merret nga Komiteti Drejtues, dhe merret në bazë të konsensusit. Së këndejmi, kërkesa për anëtarësim është refuzuar, një herë, për shkak të mungesës së konsensusit ndërmjet shteteve anëtare. Kërkesa e Kosovës për anëtarësim u refuzua në tetor të vitit 2013, dhe argumenti se Kosova nuk ishte pjesë e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECIP)² u përdor si arsye e këtij refuzimi. SEECIP nuk ishte e përfshirë në listën e Cooper-it³, andaj mungesa e konsensusit mes anëtarëve të GKSH-së, së bashku me faktorët e tjerë politikë, kontribuan në këtë përgjigje negative. Kosova është bërë pjesë e SEECIP tash së voni, dhe si rrjedhojë ajo është duke u përgatitur për ta parashtruar një kërkesë të re për anëtarësim në RACVIAC, pra duke e shfrytëzuar anëtarësimin në SEECIP si një arritje të rëndësishme drejt anëtarësimit të mundshëm në këtë organizëm (Gashi, 2014).

Duke u bërë anëtare e RACVIAC, Kosova do të mund t'i përmbush kriteret për anëtarësim në NATO, dhe se do të kontribuojë në përmirësimin e stabilitetit në rajon. Përkundër mungesës së anëtarësimit në këtë nismë, Kosova ka një formë të komunikimit dhe të bashkëpunimit me RACVIAC deri më tani, e që është një tregues se kërkesa për anëtarësimin e Kosovës mund të silltet sërish në tabelën e negociatave në mesin e strukturave të RACVIAC (Jakop, 2014).

SEDM – Ministrat e Mbrojtjes së Evropës Juglindore

Procesi i bashkëpunimit midis Ministrave të Mbrojtjes së Evropës Juglindore erdhi si rezultat i trazirave që kishin ndodh gjatë dekadës së fundit në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë. Nevoja për ta themeluar një mekanizëm të qëndrueshëm të bashkëpunimit rajonal në sektorin e mbrojtjes i solli së bashku në rajon ministrat e mbrojtjes dhe zëvendësministrat e mbrojtjes. SEDM u themelua si rezultat i një takimi të përbashkët të mbajtur në mars të vitit 1996 në Tiranë. Objektivi kryesor i këtij bashkëpunimi ishte, dhe vazhdon të jetë,

² Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore është një strukturë fleksibile e bashkëpunimit rajonal. Nisma fillimisht e kishte emrin 'Procesi i marrëdhënies të mira fqinjësore, i stabilitetit, sigurisë dhe i bashkëpunimit mes vendeve të EJI'.

³ Robert Cooper ka qenë ish ndërmjetës në dialogun Prishtinë-Beograd në kuadër të ekipit të baroneshës Ashton. Lista mbetet për shfrytëzim të brendshëm të MPJ - meqë disa zyrtarë i referohen asaj si lista e Robert Cooper. Lista i përmban disa nisma dhe organizata të mundshme në të cilat mund të bëhet anëtare e plotë Kosova pas nënshkrimit të marrëveshjes për fusnotë'.

forcimi i bashkëpunimit politik-ushtarak në rajon me qëllim të përmirësimit të stabilitetit dhe të sigurisë në Evropën Juglindore (SEDM, 2013).

SEDM përbëhet prej 14 shteteve anëtare dhe 2 shteteve të tjera anëtare në cilësinë e vëzhguesit. Shtetet anëtare të NATO-s që marrin pjesë në SEDM janë: Shtetet e Bashkuara, Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Italia, Rumania, Sllovenia dhe Turqia; anëtarët e Partneritetit për Paqe që marrin pjesë në SEDM janë: Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Ukraina, Mali i Zi, dhe Serbia (SEDM); dhe dy shtetet anëtare vëzhguese janë Gjeorgjia dhe Moldavia (Procesi i vlerësimit SEDM, 2011).

Kryesia e SEDM-së ka marrë kërkesa prej institucioneve të Kosovës që ajo ta merr statusin e vëzhguesit në SEDM. Megjithatë, Serbia dhe Rumania kanë dalë kundër, duke e bërë të pamundur arritjen e konsensusit që Kosova të bëhet shtete anëtare. Sa i përket kërkesës së Kosovës për t'i ndjekur aktivitetet e SEDM si vëzhguese, sekretariati i SEDM iu ka përgjigjur kërkesës së Kosovës si vijon: *"E kemi marrë kërkesën tuaj për të marrë pjesë si vëzhguese. Si rrjedhojë, sekretariati e ka futur në procedurë kërkesën tuaj me që një vendim i tillë kërkon konsensus në mesin e shteteve anëtare të SEDM. Serbia dhe Rumania e kanë paraqitur qëndrimin e tyre kundërshtues sa i përket kërkesës suaj, dhe se nuk është arritur konsensus për këtë çështje"* (Procesverbali i takimit të SEDM, 2013).

Megjithëkëtë, ende nuk dihet nëse autoritetet kosovare do të dërgojnë një kërkesë tjetër për anëtarësim, ose nëse ka ndonjë plan tjetër për takimin e radhës së SEDM (Syla, 2014).

BASHKËPUNIMI RAJONAL SA I PËRKET POLICISË DHE SUNDIMIT TË LIGJIT

SECI – Iniciativa e Evropës Juglindore për Bashkëpunim

SECI u formua në vitin 1996 nën udhëheqjen e Richard Schifter, këshilltar i posaçëm i Sekretarit të Shtetit të SHBA-ve për Evropën Juglindore në administratën e Klintonit, i cili bënte përpjekje t'i sillte rajonit stabilitet përmes themelimit të SECI. Qëllimi fillestar i SECI ishte stabiliteti, jo përmes ndihmave financiare, por përmes bashkëpunimit rajonal të kombeve të Evropës Juglindore. Kjo vinte në formë e mjeteve që do të mund të ndihmonin në rindërtimin dhe stabilizimin e rajonit. Ndihma e vetme që do të vinte prej kombeve dhe organizatave të tjera, përfshirë ato të rajonit, ishte përmes ndihmës teknike dhe ekspertizës në fushat relevante. Përkundër ndarjeve sektare dhe etnike në rajon, anëtarët e SECI janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Maqedonia, Greqia, Hungaria, Moldavia, Rumania, Jugosllavia, Kroacia, dhe Sllovenia.

Më 7 tetor të vitit 2011, SECI u shndërrua në SELEC, duke ia bartur kështu detyrat operative dhe strategjike organizatës së re të quajtur SELEC. Objektivi i SELEC është ofrimi i mbështetjes për shtetet anëtare, si dhe zgjerimi i bashkërendimit në parandalimin dhe luftimin e krimit, duke përfshirë krimin e organizuar aty ku ndodh ky krim apo duket se do të ndodh, e që është një veprimtari që i kalon kufijtë e vetëm një shteti të caktuar. Në kuadër të UNMIK-ut, Kosova ishte vëzhguese e SELEC, e cila e ka selinë në Bukuresht (SECI & SELEC, 1999).

MPJ e Kosovës e kishte dorëzuar një shkresë zyrtare, duke kërkuar informacion sa i përket çështjes së anëtarësimit të saj, më pas ia dërgoi një shkresë zyrtare kryesuesit të SEEPAG, duke parashtruar kërkesë për anëtarësim, por nuk kishte marrë ndonjë përgjigje ndaj kësaj kërkesë. Si duket, autoritetet kosovare nuk iu kishin përmbajtur procedurave për parashtrimin e kërkesave në SELEC (Elshani, 2014). Kosova ende po përballlet me pengesa që të bëhet anëtare e SELEC pas refuzimit të qartë ndaj kërkesës së saj për anëtarësim.

SEEC – Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore

Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (SEEC) nisi në vitin 1996. Kjo nismë fillimisht u quajt "Procesi i marrëdhënieve të mira fqinjësore, i stabilitetit, sigurisë dhe i bashkëpunimit mes vendeve të EJL". Kjo strukturë u paraqit nga vendet e EJL-së dhe kishte për qëllim ta përfaqësonte 'zërin unik të rajonit'. SEEC është një strukturë fleksibile, e cila u themelua nga shtetet e rajonit si shprehje e solidaritetit të tyre. Korniza e përgjithshme e SEEC përbëhet prej bashkëpunimit kryesisht në fushën e sigurisë, stabilitetit, qëndrueshmërisë, zhvillimit ekonomik, bashkëpunimit në fushën e drejtësisë, krimit të organizuar, trafikimit të narkotikëve, luftimit të krimit të organizuar, të trafikimit me persona dhe me armë. Së këndejmi, një prej përgjegjësive të shteteve anëtare është që të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën që të krijojnë dhe të hartojnë strategji të përbashkëta për stabilitetin e rajonit në mënyrë që të jenë në gjendje të reagojnë ndaj sfidave të reja në fushën e sigurisë (SEEC, objektivat kryesore).

Si një prej nismave të vetme të themeluara nga shtetet rajonale me qëllim të promovimit të demokracisë, prosperitetit, paqes dhe zhvillimit ekonomik, si dhe të integritit euroatlantik për të gjitha vendet e rajonit, SEEC përbëhet prej 12 shteteve anëtare: Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Greqisë, Maqedonisë, Moldavisë, Malit të Zi, Rumanisë, Serbisë, Sllovenisë dhe Turqisë (SEEC, Compromise Proposal of the SEEC).

Kosova synoi të bëhej anëtare e plotë në SEEC, si një ndër platformat më serioze të bashkëpunimit rajonal në Ballkan, por SEEC u la jashtë listës së Cooper-it. Sipas 'marrëveshjes për fusnotën', kërkesa për anëtarësim në SEEC ishte e paevitueshme, duke pasur parasysh që përfshirja e Kosovës do t'i sillte përfitime edhe vet SEEC, si dhe do të kontribuonte në konsolidimin e plotë të paqes dhe zhvillimit rajonal (MPJ, 2014). Në qershor të vitit 2014,

Kosova u bë anëtare e plotë e SEEEP nën kryesinë e Rumanisë, pasi e kishte pasur më herët statusin e vëzhguesit.

Mes tjerash, deklarata e SEEEP thekson: *“E kemi mirëpritur pjesëmarrjen e Kosovës në aktivitetet e SEEEP gjatë vitit të kaluar, dhe kemi vendosur ta ftojme Kosovën që të merr përherë pjesë në aktivitetet dhe takimet e SEEEP në të gjitha nivelet dhe në mënyrë të barabartë”* (Deklarata e SEEEP në samitin e Bukureshtit, 2014:5). Deklarata e miratuar prej SEEEP e bënë Kosovën pjesëmarrëse të përhershme dhe të barabartë në këtë proces (Elshani). Të qenit anëtare e plotë e SEEEP, Kosova bën progres të madh në forumin shumëpalësh rajonal. Anëtarësimi i plotë i Kosovës në SEEEP ia ka hapur dyert asaj që të kualifikohet edhe për anëtarësim në RACVIAC, të cilën e kemi përmendur më herët në këtë tekst.

ILECU – Njësia Koordinuese për Zbatimin e Ligjit Ndërkombëtar

Pas përpjekjeve të vazhdueshme për ta përforcuar bashkëpunimin rajonal, posaçërisht në fushën e sundimit të ligjit, BE-ja e ka filluar zbatimin edhe të një mori veprimesh e programesh të ndryshme. Me synim të përforcimit të platformave kombëtare për policinë ndërkombëtare dhe të bashkëpunimit në zbatimin e ligjit, BE-ja i ka themeluar Njësitë Koordinuese të Zbatimit të Ligjit Ndërkombëtar (ILECUs) për shtetet e Evropës Juglindore.

ILECU është një projekt rajonal i BE-së me qëllim të themelimit të njësive koordinuese kombëtare dhe të fuqizimit të bashkëpunimit në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të dy projekteve të financuara të BE-së – ILECUs dhe DET-ILECUs II, u krijua një rrjet nën udhëheqjen e Shërbimit Inteligent Penal të Austrisë, i cili aktualisht përbëhet prej njësive të shtatë vendeve si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia dhe Moldavia.

Synimi i ILECUs në rajon është që të ketë një qendër të vetme, d.m.th., një institucion/njësi në secilin vend të rajonit, e cila mundëson kontakt dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet tyre dhe me organizatat ndërkombëtare, si Interpol, Europol, Eurojust, Frontex, Qendrën SECI (SELEC), OLAF, Sistemin Informativ Shengen, dhe SIRENE, zyrtarët ndërlidhës (kombëtarë dhe të huaj). Së këndejmi, ILECUs ofron një platformë qendrore të koordinimit, komunikimit dhe të shkëmbimit të informatave mes njësive dhe institucioneve të ndryshme që janë pjesë e agjencive kombëtare dhe ndërkombëtare të zbatimit të ligjit në vendet e Ballkanit Perëndimor. (ILECU, 2012).

Kosova u bë pjesë e ILECU në bazë të vendimit për themelimin e Njësive Koordinuese për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatimin e Ligjit në kuadër të Policisë së Kosovës (PK) (Elshani). Në qershor të vitit 2011, qeveria e Kosovës mori vendim për themelimin e ILECU në kuadër të PK-së. Kjo njësi do ta inkorporojë zyrën e ILECU në kuadër të KP-së, dhe Mekanizmat e Policisë Ndërkombëtare, INTERPOL, EUROPOL, dhe FRONTEx (MoU, 2011: Art. 1).

Duke e pasur parasysh faktin që Kosova nuk ka nënshkruar marrëveshje strategjike me EUROPOL-in, si dhe fakti që nuk është anëtare e INTERPOL-it, ILECU e Kosovës shërben si mekanizëm që e lehtëson komunikimin midis INTERPOL-it të përfaqësuar nga administrata e UNMIK-ut, dhe EUROPOL-it të përfaqësuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë (Elshani). Sido qoftë, ILECU ka dëshmuar së qeni një mënyrë e drejtpërdrejtë, edhe pse joformale, e komunikimit dhe koordinimit ndërmjet shteteve rajonale.

PCC SEE – Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore

Ideja e themelimit të projektit PCC SEE kishte ardhur prej Austrisë dhe Gjermanisë në bazë të parimit të pronësisë rajonale. U bënë negociata me vite për ta realizuar bashkëpunimin e përbashkët policor. Konventa për Bashkëpunimin Policor për Evropën Juglindore u nënshkrua në vitin 2006 prej ministrave të brendshëm të shteteve pjesëmarrëse, si Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Moldavisë, Malit të Zi, Rumanisë, dhe Serbisë. Bashkëpunimi policor ndërkombëtarë kërkon një kornizë të duhur ligjore me qëllim që të jetë plotësisht efektiv (Banutai, 2013: 72-73). Në thelb, kjo nismë synon ta bëjë Evropën Juglindore 'që t'i përvetësojnë standardet e shengenit përmes nënshkrimit të një konvente shumëpalëshe për përmirësimin e bashkëpunimit strategjik policor në rajon' (PCCSEE, 2014).

Kosova nuk është pjesë e PCC SEE për shkak të arsyeve politike dhe mungesës së konsensusit midis shteteve anëtare. Përkundër faktit se Kosova mund të kërkojë t'i bashkohet dhe ta nënshkruajë kontratën, duke e shprehur vullnetin për përvetësimin e konventës, statusi politik e pengon dukshëm pozitën e saj në raport me PCC SEE. Duke qenë e lënë jashtë këtij mekanizmi të madh organizativ, Kosova nuk mund të përfitojë ende prej disa programeve dhe projekteve të saj (Intervistë me zyrtarë të PCC SEE, 2014)

Rrjeti i prokurorëve të Ballkanit Perëndimor

Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor është një nismë tjetër rajonale në fushën e sundimit të ligjit. Kjo nismë synon të krijojë lidhje të drejtpërdrejta midis shërbimeve prokuroriale në vendet e Ballkanit Perëndimor me qëllim që të hetohen dhe persekutohen në mënyrë efektive grupet e krimit të organizuar që veprojnë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Projekti ka për synim të krijojë një rrjet dhe kapacitete profesionale për të kryer hetime të përbashkëta, për të shkëmbyer informata për luftimin e krimit të organizuar dhe të rasteve të korrupsionit, në të cilat implikohen disa shtete, si dhe të formave të tjera të krimeve të rënda, grupeve kriminale dhe vrasjeve (RCC, 2014: 56-57).

Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor është një rrjet profesional i prokurorëve publik, i cili u themelua në vitin 2005. Më vonë në vitin 2010, ky rrjet u fuqizua më shumë, si dhe e zgjeroi fushëveprimin e tij, menjëherë pas nënshkrimit të një memorandumit të mirëkuptimit nga kryeprokurorët e secilit vend pjesëmarrës. Rrjeti përbëhet prej gjashtë shteteve si Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, dhe Serbia, dhe se funksionon në bazë të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet gjashtë pikave kombëtare të kontaktit, që e kanë po ashtu edhe funksionin si pika kryesore juridike për ILECU. Rrjeti mbështetet fuqishëm prej BE-së dhe Këshillit të Evropës.

Duke e pasur parasysh që Kosova nuk është pjesë e Këshillit të Evropës nënkuptohet se ajo nuk mund ta nënshkruajë cilëndo prej konventave evropiane që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e drejtësisë (Ligji nr. 04/L për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale, 2011). Si rezultat, Kosova e ka materializuar bashkëpunimin në gjyqësor vetëm në baza bilaterale me shtetet e rajonit, të cilat e kanë njohur Kosovën. EULEX shërben si ndërmjetësues mes Kosovës dhe shteteve të rajonit që nuk e kanë njohur Kosovën.

Kosova e ka aktualisht Ligjin për bashkëpunim juridik ndërkombëtar (Ligji nr. 04/L-031), i cili është hartuar dhe, më vonë, miratuar nga kuvendi në korrik të vitit 2013. Deri më tani, Kosova i ka nënshkruar një varg marrëveshjesh bilaterale me shtetet e tjera të rajonit. Kosova ka nënshkruar po ashtu marrëveshje bilaterale për ndihmë reciproke juridike me Shqipërinë dhe Italinë. Ministri i Drejtësisë vepron sipas kërkesave për ndihmë reciproke juridike të cilat pranohen prej shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, ose drejtpërdrejtë, ose përmes EULEX-it. UNMIK-u mbetet pika zyrtare e kontaktit për Interpol-in.

Megjithatë, duke mos mundur të jetë pjesë e nismave kryesore rajonale për sundimin e ligjit, Kosova nuk mund të përfitojë prej trajnimeve e seminareve të përbashkëta për gjyqtarë e prokurorë; nuk mund të bashkëpunojë me lehtësi me vendet e tjera, dhe; se bashkëpunimi bilateralë merr shumë kohë dhe nuk është shumë efikas. Po ashtu, rastet e bashkëpunimit në gjyqësor, të cilat janë ndërmjetësuar prej EULEX-it ose UNMIK-ut, kanë qenë më të ngadalshmet dhe ato që kanë paraqitur një varg sfidash procedurale. Andaj, angazhimi i plotë në nismat e tilla multilaterale mund ta ndihmojnë Kosovën që të merret më me efikasitet me rastet në fushën e drejtësisë e që kanë karakter rajonal. (Gegaj, 2014).

PËRFUNDIM

Zgjerimi i BE-s dhe NATO-s shihen si përfitim si për BE-n dhe NATO-n, duke sjellë stabilitet dhe siguri në rajon, ashtu edhe për shtetet aspiruese përmes fillimit dhe përvetësimit të reformave demokratike dhe ekonomike. Si rrjedhojë, BE-ja në bashkëpunim me shtetet aspiruese të rajonit, i ka nisur disa projekte dhe programe që kanë për qëllim rritjen e bashkëpunimit rajonal në fushën e sigurisë, mes tjerash, në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për Kosovën, anëtarësimi i plotë në organizatat ndërkombëtare shihet si instrument për të siguruar pozitë të barabartë mes shteteve të rajonit, si dhe për ta rritur bashkëpunimin me këto të fundit. Duke e pasur parasysh rëndësinë e përfshirjes së saj në rajon, Kosova ka negociuar me Serbinë lidhur me modelet se si të mund të merr pjesë 'në mënyrë të barabartë' në nismat rajonale dhe të bëhet anëtare e dhjetëra mekanizmave rajonalë. Megjithatë, përkundër faktit që 'marrëveshja për fusnotën' e parashihte një të ardhme më të mirë dhe më të ndritshme për Kosovën në arenën rajonale dhe ndërkombëtare, për fat të keq, pengesat në procesin e zbatimit dhe kundërshtimi i Serbisë kanë bërë që ky proces të jetë më i vështirë dhe më i gjatë për institucionet e Kosovës.

Identifikimi i institucioneve të sigurisë me shtetësinë e Kosovës e kanë bërë më të vështirë integrimin e saj në nismat rajonale të sigurisë. Deri më tani, Kosova ka arritur të bëhet anëtare e RCC – një anëtarësim që pritej t'ia hapte Kosovës dyert e bashkëpunimit në nivel rajonal. Përkundër disa sukseseve, Kosova ende përfaqësohet nga administrata e UNMIK-ut dhe EULEX-it kur kemi të bëjmë me Interpol-in dhe Europol-in, ndërsa në raste të tjera as nuk ka arritur të ketë ndonjë përfaqësim, e as ndonjë lloj të pjesëmarrjes apo përfshirjes së saj në to. Mungesa e Kosovës në nismat rajonale e bënë të paplotë procesin e bashkëpunimit rajonal, si dhe nuk kontribuon në normalizimin e marrëdhënieve mes shteteve të rajonit.

REKOMANDIME

Qeveria e Kosovës – nënshkrimi i ‘marrëveshjes për fusnotën’ duhet të pasohet me një platformë më të mirëfilltë për zbatimin e saj. Qeveria duhet të jetë më konsistente dhe më e unifikuar me qëllim që të sigurojë pjesëmarrje më të mirë në nismat rajonale të sigurisë. Krahas strategjive, nevojitet edhe një bashkëpunim dhe bashkërendim më i mirë mes MPJ-së, FSK-së dhe PK-së për ta përmirësuar pozitën e Kosovës në nivel rajonal. Institucionet relevante duhet ta trajtojnë çështjen e Kosovës në kuadër të një apo më shumë kornizave rajonale, pra aty ku e shohin që është me interes të përfshihet Kosova. Pjesëmarrja në nismat rajonale nuk duhet të jetë qëllim në vetvete, por mënyrë për ta forcuar shtetësinë dhe institucionet e saj.

Bashkimi Evropian – duhet të kërkojë mundësi të përfshirjes së Kosovës në nismat relevante, duke eksploruar opsione të reja mes statuseve të ndryshme me qëllim që të sigurohet që Kosova të merr pjesë në nismat rajonale të sigurisë. Po ashtu, BE-ja duhet t’i bëjë presion qeverisë së Serbisë që ta respektojë dhe ta zbatojë ‘marrëveshjen për fusnotën’, sipas së cilës Kosova nuk duhet të kufizohet që të merr pjesë në organet dhe nismat rajonale.

UNMIK-u dhe EULEX-i – duhet të bëjnë më shumë për kalimin e përgjegjësive tek institucionet e Kosovës, në veçanti në lidhje me komunikimin me Interpol-in dhe Europol-in.

Nismat rajonale të sigurisë – pritet që t’i shtojnë përpjekjet në mënyrë që qëllimi kryesor i bashkëpunimit rajonal të jetë mbi qëndrimet e shteteve anëtare. Nismat rajonale për siguri inkurajohen që ta arsyetojnë në mënyrë proaktive nevojën e anëtarësimit të Kosovës në to me qëllim që të deklarohet, së paku formalisht, bashkëpunimi i plotë dhe holistik në Evropën Juglindore.

LISTA E ANEKSEVE

Përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale të sigurisë

Nismat/ mekanizmat	Vëzhgues / mysafir	Ka kërkuar anëtarësim	Anëtare / Pjesëmarrëse	Pa marrëdhënie
SEKTORI I MBROJTJES				
Karta e Adriatikut	✓	✓		
PSOTC – Qendra Trajnuese për përkrahjen e Operacioneve Paqësore				✓
RACVIAC – Qendra për Asistim në Implementim dhe Verifikim të Kontrollit Rajonal të Armëve		✓		
SEDM – Ministrat e Mbrojtjes së Evropës Juglindore				✓

SEKTORI I POLICISË DHE I SUNDIMIT TË LIGJIT				
SECI – Iniciativa e Evropës Juglindore për Bashkëpunim				✓
SEECF – Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore			✓	
ILECU – Njësia Koordinuese e Zbatimit të Ligjit Ndërkombëtar			✓	
PCC SEE – Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore				✓
Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor				✓

BIBLIOGRAFI

- 1244, UNSC Resolution. "United Nation Security Council - Resolution 1244." Qershor 1999. Qershor 2014 <<http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf?OpenElement>>.
- Agreement, Adriatic Charter. "UNITED STATES-ADRIATIC CHARTER—SUPPORT." 2003. Qershor 2014 <<http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/STATUTE-117/pdf/STATUTE-117-Pg2964.pdf>>.
- ARSS, Qeveria e Republikës së Kosovës. "Analizë e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë së Republikës së Kosovës (RSSS)." Mars 2014. Maj 2014 <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analiza_e_Rishikimit_Strategjik_te_Sektorit_te_Sigurise_se_RKS_06032014.pdf>.
- Banutai, Emanuel. Police Cooperation Convention for South East Europe: Lessons Learned. Ljubljana, 2013.
- Brunwasser, Matthew. Kosovo and Serbia Reach Key Deal. 2012. Qershor 2014 <http://www.nytimes.com/2012/02/25/world/europe/25iht-kosovo25.html?_r=0>.
- Bugajski, Janusz and Heather A. Conley. A New Transatlantic Approach for the Western Balkans. Washington DC: Center for Strategic and International Studies CSIS, 2011.
- Busek, Erhard and Björn Kühne. From Stabilisation to Integration: The Stability Pact for South East Europe. Wien: Boehlau, 2010.
- Bytyci, Fatos. Kosovo to create national army of 5,000 soldiers. 2014. Qershor 2014 <<http://www.reuters.com/article/2014/03/04/us-kosovo-army-idUSBREA231E820140304>>.
- Commission, European Union. First Annual Report on the implementation of the EU Internal Security Strategy. Brussels: EU Commission, 2011.
- . Kosovo Progress Report 2013. Brussels: EU Commission, 2013.
- Council, Atlantic. Kosovo on Stabilizing Peace With Serbia. 2014. June 2014 <<http://www.atlanticcouncil.org/events/past-events/kosovo-on-stabilizing-peace-with-serbia>>.
- Cukali, Besnik. Peace Support Operation Training Centre. 2003. May 2014 <<http://www.nato.int/sfor/indexinf/articles/031211a/t031211a.htm>>.
- Elshani, Veton. International Police Cooperation. 21 maj 2014.
- Evaluation, SEDM Process. SEDM. 2011. May 2014 <http://www.mapn.ro/sedm/library/meetings/Group_of_Experts/1st_Group_of_Experts_Meeting_Rome_26-27_April_2012/Annex%20A%20SEDM%20process%20evaluation%20document%20-%2016th%20March%202012.pdf>.
- Gashi, Asdren. Anëtarësimi i Kosovës në RACVIAC. Qershor 2014.
- Geci, Faruk. Aspiratat e Kosovës për anëtarësim në kartën e adriatikut. 16 qershor 2014.
- Gegaj, Arber. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e sundimit të ligjit. Maj 2014.

ILECU. Description of the ILECU's Project. 2004. May 2014 <<http://www.iom.int/seguridad-fronteriza/lit/fw/ilecus-short.pdf>>.

Initiative, Foreign Policy. Kosovo: New Reality of Regional Cooperation. Sarajevo: Friedrich Ebert Stiftung, 2013.

Jakop, Zdravko. Kosovo Membership in RACVIAC. Qershor 2014.

Kušljugić, Mirza. Development of Regional Cooperation in the Western Balkans and EU Integration – Evaluation of Regional Cooperation Initiatives. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung FES, 2009.

Law No. 04/L on International Legal Cooperation in Criminal Matters. 2011. 2011 2014 <http://www.md-ks.org/repository/docs/Ligji_per_bashkepunim_Juridik_%28anglisht%29.pdf>.

Lehne, Stefan. Kosovo and Serbia: Toward a Normal Relationship. Washington DC: Carnegie Edowment for International Peace, 2012.

Lepore, Pasqualina. Beyond the Asterisk Agreement. Rome: Istituto Affari Internazionali I.A.I., 2012.

Lopandic, Dusko. Regional Initiatives in South-easter Europe. Belgrade: Institute for International Politics and Economic, 2009.

MFA. Minister Hoxhaj seeks Kosovo`s membership in SEECF. 2014. May 2014 <<http://www.mfa-ks.net/?page=2,4,2246>>.

MFA, Ministry of Foreign Affairs. "Becoming a Part of Community of Nations." Kosovo's New Diplomat No 3. Year II. Buletin dymujor i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës (2012): 6.

—. "Strategjia për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës." Qershor 2011. Qeveria e Kosovës, Maj 2014 <http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Arritjen_e_Njohjes_se_Plote_Nderkombetare_te_Republikes_se_Kosoves_SHQ.pdf>.

Minniti, Marco. South East European Security and the Role of the NATO-EU Partnership. Brussels: NATO, 2004.

NATO. NATO initiative for the Southeastern Europe. Brussels: NATO, 2001.

Intervistë me Zyrarët e MPJ. Përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale të sigurisë. 15 qershor 2014.

Zyrarët e PCC SEE. Anëtarësimi i Kosovës në PCCSEE. Korrik 2014.

Plan, Marti Ahtisaari. "The Comprehensive proposal for Kosovo Status." Mars 2007. 6 qershor 2014 <http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf>.

Police, Kosovo. ILECU in KP Bridge with International Police Organizations. Prishtina: Kosovo Police, 2010.

PSOTC. PSOTC - Historical Overview. 2008. Maj 2014 <http://mod.gov.ba/OS_BIH/struktura/Komanda_z_a_podrsku/KOID/PSOTC/about_us/history/?id=26697>.

RACVIAC. Agreement on RACVIAC - Center for Security Cooperation. 2001. Maj 2014 <http://www.racviac.org/downloads/documents/RACVIAC_New_Agreement.pdf>.

- . RACVIAC's Mission. 2010. Qershor 2014 <<http://www.racviac.org/about/mission.html>>.
- RCC, Regional Cooperation Council. RCC and Regional Initiatives and Task Forces in South East Europe. 2012. Maj 2014 <<http://www.rcc.int/pages/35/rcc-and-regional-initiatives-and-task-forces-in-south-east-europe>>.
- . Strategy Work and Programme 2011-2013. Sarajevo: RCC, 2010.
- Remikovic, Drazen and Lindita Karadaku. Regional Co-operation Council membership will be a boost for Kosovo. 2013. June 2014 <http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2013/03/11/feature-03>.
- Rracaj, Akrem. Bashkëpunimi i Policisë me Interpolin dhe Europolin. 26 maj 2014.
- Sandole, Denis. "The Balkans Stability Pact As a Regional Conflict management and Prevention ." 2009.
- SEDM. Historical Overview. 2013. Maj 2014 < <http://www.mapn.ro/sedm/structure/history/index.php>>.
- Procesverbali i takimit të SEDM. 2013. Maj 2014.
- SEDM Objectives. 2013. Maj 2014 <<http://www.mapn.ro/sedm/concept/objectives/index.php>>.
- SEE, PCC. Background and Objectives. 2014. May 2014 <<http://www.pccseesecretariat.si/index.php?item=9&page=static>>.
- SEECF. Compromise Proposal of the SEECF. 1996. Maj 2014.
- . Main Objectives. 2010. May 2014 <<http://www.stabilitypact.org/seecf/>>.
- SELEC, SECI &. Convention of The South European Law Enforcement Center. 1999. Maj 2014 <<http://www.selec.org/m106/About+SELEC>>.
- State, US Department of. "Adriatic Charter." 2011. Qershor 2014 <www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>.
- Syla, Shkelzen. Kosovo Aspirations for Membership in the Adriatic Charter. 16 qershor 2014.
- Telychkin, Oleksiy. UNMIK Role in Facilitating Communication with Interpol. Qershor 2014.
- Todoric, Vladimir and Leon Malazogu. Belgrade –Prishtina Dialogue: Transformation of Self-interest Required. Prishtina: New Policy Center NPC, 2011.
- Understanding, Memorandum of. ILECU. 2011. Maj 2014 <<http://www.psh-ks.net/repository/docs/ILECU.pdf>>.
- Zela, Granit. "Strategic Culture of the Western Balkans States." Mediterranean Journal of Social Sciences (2013): 636-639.

INTERVISTAT

Akrem Rracaj – Drejtor për Trajnimet e Specializuara për Policinë e Kosovës

Arber Gegaj – Drejtor i Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë

Asdren Gashi – Sekretar i parë në Ambasadën e Kosovës në Zagreb

Zyrtarët nga PCC SEE

Oleksey Telychkyn – Këshilltar i lartë në polici, Administrata e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)

Rafael Jarmuzek – Kol. Rafal Jarmuzek – Zyrtar ndërlidhës ushtarak në UNMIK

Shkelzen Sylja – Sekretar i përgjithshëm i MFSK-së dhe Faruk Geci – Drejtor i departamentit për politikë dhe plane

Veton Elshani – Shef i sektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe lokal në Policinë e Kosovës (ILECU)

Brigadier General Zdravko Jakop – Zëvendës drejtor i RACVIAC

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

355.45(496.510(047)

Emini, Donika

Anëtarësimi dhe përfaqësimi i Kosovës në nismat rajonale të sigurisë / Donika Emini. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2014. - 32 f. : ilustr. me ngjyra ; 17 cm. x 23.5 cm.

Bibliografi : f. 26-28

ISBN 978-9951-679-07-7

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-07-7



9

789951

679077